Në përputhje me skemën e Akreditimit të Aeroporteve të ACI-t në Evropë për "Përcaktimin e gjurmës së emetimit të dioksidit të karbonit", specifikisht Niveli i parë i kësaj skeme, si dhe në përputhshmëri me Protokollin e Gazeve që shkatëjojnë efektin serra, burimet e energjisë në aeroport klasifikohen në dy kategori:

- Kategoria e parë – burime emetimesh të drejtpërdrejta të kontrolluara të energjisë nga burime të tilla si impianti i ngrohjes, gjeneratorët e emergjencës, pajisjet e shërbimit në tokë dhe automjetet aeroportuale;
- Kategoria e dytë – burime emetimesh jo të drejtpërdrejta të energjisë nga burime të tilla si energjia elektrike e blerë.

Niveli total i emetimeve të dioksidit të karbonit në TIA për vitin 2013 u llogarit në 1,023.5 ton CO₂. Këto emetime janë paraqitur në Tabelën 2 përkatesisht për vitet 2011-2013.

Emetimet vjetore të CO₂ për vitet 2011-2013

Burimi	Emetimet vjetore të vitit 2011 CO ₂ (ton)	Emetimet vjetore të vitit 2012 CO ₂ (ton)	Emetimet vjetore të vitit 2013 CO ₂ (ton)
Kategoria 1 (emetime të drejtpërdrejta)	963.80	1,116.00	982.10
Kategoria 2, (emetime jo të drejtpërdrejta)	73.62	69.01	41.40
Totali (Kategoria 1 dhe 2)	1,037.42	1,185.01	1,023.50

Zbatimi i masave të përshtatshme për zvogëlimin e konsumit total të energjisë dhe optimizimin e energjisë eficiente të aeroportit rezultoi me një reduktim prej 1% në emetimet e gjurmës së karbonit krahasuar me të dhënat e vitit bazë 2011.

Si pjesë e Planit të Menaxhimit të Dioksidit të Karbonit, TIA përmirësoi së fundmi nivelin e akreditimit nga niveli 1 i përcaktimit të gjurmës së karbonit në nivelin 2 të reduktimit të kësaj gjurme bazuar në objektivat e reduktimit të energjisë së dioksidit të karbonit. Gjithë stafi i TIA-s ka kontribuar në përmbushjen të kësaj arritjeje të madhe si përgjigje ndaj ndryshimeve klimatike.

Health and Safety

Shëndeti dhe Siguria



OCCUPATIONAL HEALTH & SAFETY

In order to provide a safe working environment for all Airport staff and its customers and to ensure compliance with the respective regulatory framework, TIA has introduced more measures aimed at improving and maintaining employee occupational health and safety. Preventive actions and training for Airport employees with regard to health and safety issues were carried out in 2014, and are summarised as follows:

- Airside Safety Awareness Training was organised for TIA subcontractor staff aiming to make them aware of safety issues, compliance with safety procedures and regulations, and about their roles and responsibilities while performing their services in order to have no negative impact on Airport safety.
- Site inspections carried out in the year focused on the following issues: implementation of health and safety regulations by staff, third parties and TIA customers; working conditions in the different places of work, in compliance with Albanian law in force; use of personal protective equipment; working conditions during construction within Airport areas; and health and safety of TIA employees and contractor staff.
- Effective from the beginning of 2014, TIA introduced a Health Insurance Policy for all TIA staff, covering a wide range of benefits, including medical check-ups and hospitalisation in case of accident or illness, as well as medical prescriptions, etc. In the frame of the established policy, employment medical examinations are conducted systematically in several specialised health institutions. All records and medical examinations are consulted with the Company Doctor and filed properly for each employee and in compliance with all requirements and legislation in force.

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË

Duke patur si qëllim ofrimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë punonjësit dhe klientët e Aeroportit, në përputhje kuadrin rregullator përkatës, TIA ka kryer matje të vazhdueshme për ruajtjen dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Veprime parandaluese dhe trajnime për punonjësit e Aeroportit janë ndërmarrë gjatë 2014-s kundrejt çështjeve të shëndetit dhe sigurisë, të cilat janë paraqitur të përmbledhura si më poshtë vijon:

- Trajnime për sigurinë në zonën ajrore janë organizuar për stafin e nënkontraktorëve të TIA-s duke i ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e çështjeve të sigurisë, përputhshmërinë me procedurat e sigurisë dhe kuadrin rregullator, gjithashtu mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse gjatë ofrimit të shërbimeve në mënyrë që të mos ketë impakt negativ në sigurinë e Aeroportit.
- Inspektime të ndryshme janë kryer përgjatë vitit të përqëndruara në fushat e mëposhtme: zbatimit të rregullave për shëndetin dhe sigurinë nga stafi, palët e treta dhe klientët e TIA-s; kushteve të punës në ambiente të ndryshme pune në përputhshmëri me ligjin Shqiptar në fuqi; përdorimit të pajisjeve personale mbrojtëse; kushteve të punës gjatë aktiviteteve të ndërtimit në zonat e Aeroportit; dhe ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve të TIA-s dhe stafit të nënkontraktuar.
- TIA ka vënë në zbatim politikën e sigurimit të shëndetit për të gjithë stafin e TIA-s që në fillim të vitit 2014, e cila ofron një sërë përfitimesh për punonjësit, duke përfshirë këtu kontrollin shëndetësor dhe hospitalizimin në rast aksidenti apo sëmundje, si edhe konsulta apo barna mjekësore, etj. Në vijim të zbatimit të kësaj politike janë kryer në mënyrë periodike kontrole mjekësore për të gjithë punonjësit në institucione të ndryshme të specializuara të shëndetit. Gjithë ekzaminimet mjekësore dhe dokumentacioni shëndetësor përkatës janë shqyrtuar dhe konsultuar nga Doktor i Kompanisë, të cilat më pas arkivohen përkatësisht për secilin punonjës në përputhshmëri të plotë me gjithë kërkesat dhe legjislacionin në fuqi.

The Airport strives to offer its employees and all staff placed in the Airport premises an environment and working conditions that are pleasant and fair. In addition to the measures mentioned above, TIA has undertaken monitoring of environmental parameters in compliance with health and safety legislation as follows:

- Measurement of main microclimate parameters (CO₂, relative humidity, air temperature, air movement and light intensity) and PM_{2.5} (particles of diameter less than 2.5 microns that impact directly human health);
- Noise measurements inside the passenger terminal;
- Air quality measurements that include monitoring of levels of CO, Volatile Organic Compounds (VOCs), hydrogen sulphide (H₂S) and oxygen (O₂);
- Exposure measurement of ionising radiation for employees exposed professionally to ionising radiation and provision of dosimetry services.

The measurements carried out by TIA and the results obtained from the monitoring of the above-mentioned parameters confirm the status of compliance with the respective standards for a proper working environment for TIA staff, third parties and customers.

HEALTH & SAFETY AT CONSTRUCTION SITES

Before commencement of any construction works, no matter whether they are large or small infrastructure or building projects, TIA carries out Environmental Impact Assessments in compliance with the Construction Monitoring Programme for Environmental Protection.

Aiming to ensure that the projects are implemented in an environmentally responsible manner, TIA cooperates continuously with the contractors responsible for carrying out the construction works on the mitigation measures to be undertaken in order to avoid or prevent land contamination, air pollution and water pollution, and minimise noise levels as a result of the activities.

The construction activities carried out at TIA during 2014 were as follows:

- Expansion of exit road at fire station;
- Continued repairs to Taxiway W & Taxiway C;
- Airfield drainage repairs;
- New drainage pipeline of 400 m to southwest of runway;
- New investment in electrical infrastructure.





Aeroporti ka për qëllim të ofrojë një mjedis dhe kushte pune të shëndetshme dhe të kënaqshme për të gjithë stafin që punon në ambientet e Aeroportit. Përveç veprimeve të sipërpërmendura, TIA ka kryer monitorime të parametrave mjedisorë në përputhshmëri me legjislacionin për shëndetin dhe sigurinë në punë, kryesisht lidhur me:

- Matje të parametrave kryesorë mikroklimatikë (gazit të dioksidit të karbonit CO₂, lagështirës relative, temperaturës së ajrit, shpejtësisë së lëvizjes së ajrit dhe intensitetit të dritës) si dhe përqendrimit të grimcave të pluhurit në ajër PM_{2.5} (grimca me një diametër më të vogël se 2.5 mikron, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut);
- Matje të nivelit të zhurmave në brendësi të terminalit të pasagjerëve;
- Matje të cilësisë së ajrit, të cilat përfshijnë monitorimin e nivelit të monoksidit të karbonit (CO), të përbërjeve organike avulluese (VOCs), të sulfurit të hidrogjenit (H₂S) dhe të oksigjenit (O₂);
- Matje të nivelit të ekspozimit të punonjësve ndaj rrezatimit jonizues si dhe kryerjen e shërbimit për dozimetra.

Matjet e kryera nga TIA si dhe rezultatet e siguruar nga monitorimet e parametrave të sipërpërmendur dëshmojnë përputhshmërinë me standardet përkatëse për një mjedis pune të përshtatshëm për të gjithë stafin, palët e treta dhe klientët e TIA-s.

SHËNDETI DHE SIGURIA NË SHESHET E NDËRTIMIT

Përpara fillimit të çdo pune ndërtimore, pavarësisht nëse janë projekte të mëdha apo të vogla ndërtimi apo infrastrukture, TIA kryen Vlerësimin e Impaktit Mjedisor në përputhje me Programin e Monitorimit të Ndërtimit të TIA-s për Mbrojtjen Mjedisore.

Duke patur si qëllim që këto projekte të zbatohen me përgjegjshmëri në ruajtje të mjedisit, TIA bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me nënkontraktorët përkatës për ndërtimet në lidhje me masat lehtësuese që duhet të ndërmerren me qëllim shmangien apo parandalimin e ndotjes së terrenit, ndotjes së ajrit apo të ujërave si dhe minimizimin e nivelit të zhurmave të shkaktuara nga punët ndërtimore.

- Zgjerimi i rrugës dalëse nga stacioni i zjarrëfikëses;
- Riparime të vazhdueshme të rrugës lidhëse W dhe rrugës lidhëse C;
- Riparime të sistemit të drenazhimit në zonën ajrore;
- Instalim i sistemit të ri të drenazhimit 400 metra në jug-perëndim të pistës;
- Investim i ri në infrastrukturën elektrike të Aeroportit.

Customers
and Social Aspects

Klientët dhe
Aspektet Sociale



PERFORMANCE MANAGEMENT

TIA is committed to ensuring a high level of quality of services oriented towards customer satisfaction and sustainable development and to continually providing compliance with all applicable legislation and quality, environment, health and safety standards.

In this regard, one of TIA's priorities is to ensure the effectiveness and efficiency of the Integrated Management System, ensuring a consistent and reliable level of standards of performance in order to meet customer needs and expectations.

Further to Company priorities and the goals and objectives set for 2014, TIA has assessed the feedback obtained from the annual customer satisfaction survey, comment cards, questionnaires and comments arriving by email or at organised meetings with airlines, airport users and other stakeholders. In considering the customers' demands and the Company projects and plans designed, several proposals were developed and actions taken to improve the level of service, consisting mainly in the following:

- Improvements to the provision of retail, food and beverages at the Airport in order to provide a better shopping experience and to provide various services and products that fit customer needs during the Airport experience.
- Improvements to the TIA website, providing more detailed information to support all users and interested persons from a customer-friendly perspective.
- Upgrading the wireless Internet connection in the Airport area in order to ensure a better service and accessibility free of charge for a half an hour for TIA customers, passengers and Airport users.

MENAXHIMI I PERFORMANCËS

TIA është e angazhuar të sigurojë një nivel të lartë të cilësisë së shërbimeve të orientuar kundrejt kënaqësisë së klientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe të sigurojë përputhshmërinë me gjithë legjislacionin e zbatueshëm në lidhje me cilësinë, mjedisin, shëndetin, sigurinë dhe menaxhimin social.

Në këtë drejtim, një nga prioritetet e TIA-s është të sigurojë që Sistemi i Integruar i Menaxhimit (SIM) të jetë sa më efektiv dhe përmbushës, duke siguruar në mënyrë të vazhdueshme nivelin e standardeve të performancës për përmbushjen e kërkesave dhe pritshmërive të klientit.

Në mbështetje të prioritetëve, qëllimeve dhe objektivave të Kompanisë për vitin 2014, TIA ka vlerësuar të dhënat e mbledhura nga studimi vjetor për kënaqësinë e klientit, fletët e përshtypjeve, pyetësorët dhe komentet e ofruara nëpërmjet e-mailit apo takimeve të organizuara me linjat ajrore, përdoruesit e aeroportit si dhe grupet e tjera të interesit. Duke marrë në shqyrtim kërkesat e klientëve si dhe projektet dhe planet për zbatim të Kompanisë, propozime të ndryshme janë shtjelluar dhe janë ndërmarrë një sërë veprimesh për përmirësimin e nivelit të shërbimit, të cilat fokusohen kryesisht në sa më poshtë:

- Përmirësime kundrejt ofrimit të shërbimeve të dyqaneve, bareve dhe restoranteve në Aeroport me qëllim që të sigurohet një eksperiencë sa më e mirë ndaj blerjeve dhe të sigurohet shumëllojshmëria e shërbimeve me një gamë më të gjerë produktesh në mënyrë që të plotësojë nevojat e klientëve gjatë qëndrimit të tyre në Aeroport.
- Përmirësime të faqes së internetit të TIA-s, duke ofruar një informacion më të detajuar dhe një përdorim më të favorshëm për gjithë përdoruesit dhe personat e interesuar.
- Përmirësime të shërbimit wireless - lidhjes me internet në zonën e Aeroportit, në mënyrë që të sigurojë një shërbim sa më të mirë dhe të aksesueshëm për të gjithë klientët e TIA-s, pasagjerët dhe përdoruesit e Aeroportit, i cili ofrohet për gjysëm ore pa pagesë.

TIA CUSTOMER SATISFACTION SURVEY

The Customer Satisfaction Survey is one of the feedback sources used by TIA over the years in order to identify passenger perceptions of the services offered, assessment of the service qualities compared with the expectations of customers and the perceived performance.

The Survey is performed annually at the beginning of the year (January–February) by a company specialised in market research contracted by TIA. Aiming to attain reliable information and representative opinions from different categories of passengers on their airport experience, 1,000 interviews are carried out in the passenger terminal.

The survey results indicate overall satisfaction with TIA (including assessment of waiting times, access and navigation, Airport appearance, services prior to flight and on arrival, terminal facilities, security and immigration, and accessibility to services), which is rated very highly by passengers given their traveling experience, frequency and expectations.

Several workshops to present the survey results, with the participation of TIA staff and Airport sub-contractor staff, were carried out in April 2014. The aim was to make staff more aware of the level of customer satisfaction, the perception on services offered and customer expectations in order to encourage involvement of all staff, subcontractors and others providing services in the Airport to continually improve the quality of services to passengers, airlines, visitors and on-site companies.

COMMENT CARDS, QUESTIONNAIRES AND MEETINGS WITH THIRD PARTIES

Aiming to obtain more opinions on the level of services offered, TIA received throughout 2014 the opinions, comments and suggestions of passengers, visitors, meeters and greeters through comment cards placed in the passenger terminal and available on the TIA website, including feedback from airlines through a filled-in Airline Questionnaire and meetings with airline representatives. The overall level of satisfaction with Airport services and facilities is generally evaluated as high.

TRAINING, AWARENESS & COMPETENCE

Given the complexity of airport functions, the use of new technologies and increasingly complex operational constraints, the continual training of staff is a priority. TIA sustains and supports such training in order to raise staff skills and competence in compliance with the Company goals, objectives and training policy.

Further to obligatory and professional dedicated trainings provided with regard to the structure and position requirements for permanent and seasonal staff by national and international qualified trainers, the Company also organised internally the following:

- Fit-For-Future workshops with the participation of TIA management and operations staff aiming at obtaining their feedback, motivation and active involvement in all Company activities.
- Workshops, trainings, refresher trainings and presentations with regard to amended documentation, the regulatory framework, including introduction of operational or procedure requirements coming from airlines and third parties, aiming to ensure their compliance, further implementation and prevention of risk of faults and mistakes.





STUDIMI MBI KËNAQËSINË E KLIENTËVE TË TIA-S

Studimi mbi Kënaqësinë e Klientit është një ndër burimet e të dhënave që është përdorur nga TIA ndër vite me qëllim që të identifikojë perceptimin e pasagjerëve për shërbimet e ofruara, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve krahasuar me pritshmëritë e klientëve dhe perceptimin e tyre për performancën në tërësi.

Ky studim kryhet çdo fillim viti (Janar-Shkurt) nga një kompani e specializuar për studimet e tregut e kontraktuar nga TIA. 1,000 pasagjerë janë anketuar në terminalin e pasagjerëve, duke patur si qëllim sigurimin e një informacioni të besueshëm dhe opinione përfaqësuese nga kategori të ndryshme pasagjerësh dhe në varësi të eksperiencës së tyre në aeroport.

Rezultatet e studimit dëshmojnë kënaqësinë e përgjithshme me TIA-n (duke përfshirë vlerësimin e kohëve të pritjes, hyrjen dhe lëvizjen, ambjentin e Aeroportit, shërbimet para fluturimit dhe në mbërritje, facilitetet në terminal, sigurinë dhe kontrollin e pasaportave dhe vizave dhe aksesin e shërbimeve në Aeroport), çka është vlerësuar shumë mirë nga gjithë pasagjerët bazuar në eksperiencën e mëparshme, shpeshtësinë e udhëtimeve si dhe pritshmërinë e tyre.

Seminare të ndryshme janë organizuar për të prezantuar rezultatet e studimit me pjesëmarrjen e stafit të TIA-s dhe stafit të nënkontraktorëve të Aeroportit gjatë prillit 2014. Qëllimi i këtyre seminareve është të ndërgjegjësojë stafin kryesisht për nivelin e kënaqësisë së klientit, mbi perceptimin e tyre për shërbimet e ofruara si dhe për pritshmëritë e klientëve në mënyrë që të inkurajojë përfshirjen e gjithë stafit, nënkontraktorëve dhe palëve të tjera që ofrojnë shërbime në aeroport në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve për pasagjerët, linjat ajrore, vizitorët dhe kompanitë e ndryshme.

FLETËT E PËRSHTYPJEVE, PYETËSORËT DHE TAKIMET ME PALËT E TRETA

Duke patur si qëllim sigurimin e një informacioni sa më të plotë mbi nivelin e shërbimeve të ofruara, TIA ka mbledhur gjatë 2014 opinionet, komentet dhe sugjerimet e pasagjerëve, vizitorëve dhe personave shoqëruar të pasagjerëve nëpërmjet fletëve të përshtypjeve të vendosura në terminalin e pasagjerëve dhe të aksesueshme në faqen e internetit të TIA-s, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin nga linjat ajrore i ofruar nëpërmjet pyetësorëve apo takimeve me përfaqësues të linjave ajrore. Vlerësimi i përgjithshëm i kënaqësisë është cilësuar kryesisht si i lartë për shërbimet dhe facilitetet e ofruara në Aeroport.

TRAJNIMET, NDËRGJEGJËSIMI DHE KOMPETENCA

Kompleksiteti i funksioneve në aeroport, përdorimi i teknologjive të reja si dhe tërësia e detyrimeve operacionale gjithmonë e në rritje bëjnë të domosdoshëm trajnimin e vazhdueshëm dhe me prioritet të stafit. TIA i mbështet dhe i përkrah trajnimet në vijimësi në mënyrë që të rritë aftësinë dhe kompetencën e stafit në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Kompanisë si dhe politikës së trajnimeve.

Përveç trajnimeve të detyrueshme dhe profesionale të kryera për stafin me kohë të plotë dhe atë sezonal në varësi të strukturës dhe kërkesave sipas pozicionit të punës të organizuara nga trajnerë të kualifikuar sipas kërkesave kombëtare dhe ndërkombëtare, Kompania ka zhvilluar gjithashtu edhe aktivitetet e mëposhtme:

- Seminare të quajtura "Fit For Future", me pjesëmarrjen e stafit menaxhues dhe atë operacional të TIA-s duke patur si qëllim marrjen e vlerësimeve dhe opinioneve të vetë stafit, rritjen e motivimit për punën dhe përfshirjen sa më aktive në gjithë aktivitetet e kompanisë.
- Seminare, trajnime të ndryshme dhe suplementare, prezantime lidhur me dokumentacionin e përditësuar, kuadrin rregullator, duke përfshirë gjithashtu edhe paraqitjen e kërkesave operacionale dhe proceduriale të ardhura nga linjat ajrore dhe palët e treta, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së tyre, zbatimin e mëtejshëm dhe parandalimin e riskut për gabime apo keqkuptime të mundshme.

Social and Community Projects

Projektet Sociale dhe Komunitare



SOCIAL MANAGEMENT

An important objective of TIA remains cooperation with the community. The Company aims to offer job opportunities through a policy of encouraging applications from local communities.

Another very important issue at TIA is gender equality. Some 35 percent of all full-time employees are women, while 62.5 percent of management staff are women, and 35.4 percent of employees live in the communes near the Airport. The average age of TIA staff in 2014 was 39.6 years.

COMMUNITY PROJECTS

TIA and AviAlliance have demonstrated special care towards preservation of the Airport environment and have shown social responsibility sensitive to the development of local communities, confirming in this way

strong corporate responsibility. Also, through donations it has contributed to the creation of an appropriate environment for the pupils of Rinas school. In 2014, the following improvements were made:

- Removal of degraded wooden windows, with repairs and painting of the frames, and subsequent installation of 150 m² of duraluminium around the external windows and doors;
- Painting of the school facade and the ground-floor hall;
- Creation of simple gardens with decorative flowers, with a surface area of 70 m²;
- Full restoration of pre-school premises. The existing degraded and damp floors were removed and replaced by new flooring following technical standards; in addition, six small tables and 20 small chairs were purchased for the kindergarten.

WORLD ENVIRONMENT DAY ON THE AIRPORT PREMISES

As part of its corporate responsibility programme, TIA raises environmental awareness through celebration at the Airport of World Environment Day in cooperation with the Youth Centre Borderless, organising a special environmental awareness activity.

The concept has arisen from the indifference of youngsters and the community with regard to environmental issues. Borderless implemented a project entitled Mobilising Youth to Bring Environmental Changes, the aim of which was to involve youth in protecting the environment, acting as inspirational representatives of the entire community around the Airport area. This environmental and social activity is promoted in the media – newspapers and magazines and social network sites – in order to inform a large number of people.

MENAXHIMI SOCIAL

Një objektiv i rëndësishëm i TIA-s është mbajtja e një niveli të lartë bashkëpunimi me komunitetin. Kompania ofron mundësi punësimi nëpërmjet një politike inkurajimi të aplikimeve për punë nga zona e komunitetit përreth.

Një tjetër çështje e rëndësishme për TIA-n është barazia gjinore. Në tërësi, 35 përqind e gjithë punonjësve me kohë të plotë janë femra, ndërkohë që 62.5 përqind e stafit menaxhues janë femra dhe 35.4 përqind e punonjësve jetojnë në komunat përreth aeroportit. Mesatarja e moshës së stafit të TIA-s shkon në 39.6 vjeç.

PROJEKTET KOMUNITARE

TIA dhe AviAlliance kanë demonstruar kujdes të veçantë kundrejt ruajtjes së mjedisit në aeroport dhe kanë treguar përgjegjësi të ndjeshme sociale në zhvillimet e komunitetit lokal duke konfirmuar në

këtë mënyrë një përgjegjshmëri të lartë sociale. Gjithashtu nëpërmjet donacioneve kanë kontribuar në krijimin e mjediseve të përshtatshme për nxënësit e shkollës së Rinasit. Në vitin 2014 u realizuan përmirësimet e mëposhtme:

- Heqja e dritareve të amortizuara prej druri, riparimi i fashaturave dhe lyerje, vendosja e 150m² dyer dhe dritare prej duralumini në pjesën e jashtme;
- Lyerja e fasadës së shkollës dhe katit të parë;
- Krijimi i disa lulishteve të thjeshta me lule dekorative në një sipërfaqe prej 70m²,
- Restaurimi i plotë i mjediseve të kopshtit parashkollor. Shtresa e dyshemesë ekzistuese e degraduar u hoq dhe u zëvendësua me shtresë të re sipas parametrave teknike, dhe për më tepër, 6 tavolina dhe 20 karrige të vogla u siguruan për këtë kopsht.

DITA BOTËRORE E MJEDISIT NË AEROPORT

Si pjesë e programit të saj për përgjegjësinë sociale, TIA rriti ndërgjegjësimin nëpërmjet festimit në aeroport të ditës botërore të mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Rinore pa Kufinj duke organizuar një aktivitet të veçantë mjedisor ndërgjegjëses.

Koncepti ka lindur nga indiferenca e të rinjve dhe komunitetit në lidhje me çështjet mjedisore. Qendra Rinore pa Kufinj zbatoi projektin e titulluar "Mobilizimi i të rinjve për të sjellë ndryshimet mjedisore", qëllimi i të cilit ishte përfshirja e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit duke vepruar si përfaqësues inspirues për të gjithë komunitetin rreth zonës së aeroportit. Ky aktivitet mjedisor dhe social është promovuar në media, gazeta, revista dhe në rrjete sociale në mënyrë që të informohet publiku i gjerë.

Airport Main Events

Ngjarjet Kryesore



February 2014

Tirana International Airport experienced positive growth in passenger numbers in 2013. TIA passenger figures up 5.5 percent

Passenger numbers at Tirana International Airport (TIA) rose by 5.5 percent in 2013. Despite the bankruptcy of the main local carrier BelleAir, officials said that last year positive numbers were recorded for passengers traveling through the Airport, and that the current year is following this trend. The figures are not so striking in terms of Aircraft Traffic Movements (ATM), which were down 2.9 percent on 2012, and cargo statistics, which fell by 4.2 percent.

In 2013, the airlines carrying most passengers to and from Tirana were Belle Air (46.7%), Air One (10.9%), Alitalia

(9.0%), Austrian Airlines (8.2%) and Turkish Airlines (6.9%). Currently, 13 airlines fly in to and out of TIA, connecting the Albanian capital directly with 20 destinations.

March 2014

Tirana International Airport presents jointly with National Tourism Agency at ITB a positive message on Albania

ITB Berlin 2014, the prestigious world tourism trade fair, hosted the joint participation of the Albanian National Tourism Agency, Tirana International Airport (TIA) and 18 tour operators. Together these partners presented to the world-wide tourism industry Albania as a new and exciting tourism destination.

The involvement of TIA at ITB Berlin is part of the airport's strategy to meet major international organisations and tourism stakeholders to promote the country more effectively in the international tourism market.

At ITB, a press conference was held by TIA and its partners with representatives of the international media, including journalists from the German tourism market. The Airport supported the event through its organisation and presentation of Albania as an interesting tourism destination.

The press conference was given by Albania's Minister of Urban Development and Tourism, Mrs Eglantina Gjermeni, Ambassador in Berlin, Mr Artur Kuko, Director of Communication of Tirana International Airport, Mrs Arlinda Çauholli, and Director of the National Tourism Agency, Mrs Julinda Dhame.

Shkurt 2014

Tirana International Airport shënoi rritje në numrin e pasagjerëve në 2013. Shifrat e numrit të pasagjerëve të TIA-s shënuan një rritje prej 5.5 përqind

Numri i pasagjerëve në Tirana International Airport (TIA) shënoi një rritje prej 5.5 përqind në vitin 2013. Pavarësisht falimentimit të shoqërisë kryesore vendase Belle Air, zyrtarët u shprehën se gjatë vitit të kaluar u regjistruan shifra pozitive për sasi të pasagjerëve të cilët përdoren aeroportin dhe që viti aktual po ecën me të njëjtin ritëm. Shifrat nuk janë të tilla për sasi të Levizjeve të Trafikut Ajror (ATM) të cilat shënuan një zbritje prej 2.9% në vitin 2012 dhe statistikën e kargos të cilat kanë zbritur me 4.2%.

Në vitin 2013, shoqëritë ajrore të cilat kanë transportuar pjesën më të madhe të pasagjerëve nga dhe në drejtim të Tiranës ishin Belle Air (46.7%), Air One (10.9%), Alitalia (9.0%), Austrian Airlines (8.2%) dhe Turkish Airlines (6.9%). Aktualisht janë 13 shoqëri ajrore të cilat fluturojnë në TIA duke lidhur kryqytetin Shqiptar në mënyrë direkte me 20 destinancione.

Mars 2014

Tirana International Airport së bashku me Agjencinë Kombëtare të Turizmit prezantojnë një mesazh pozitiv për Shqipërinë në ITB

ITB Berlin 2014, panairi tregtar prestigjioz për turizmin botëror organizoi pjesëmarrjen e përbashkët të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Tirana International Airport (TIA) dhe 18 operatorëve turistikë. Së bashku, këto partnerë i prezantuan industrisë mbarë-boterore të turizmit Shqipërinë si një destinacion i ri dhe tërheqës turistik.

Përfshirja e TIA-s në ITB Berlin është pjesë e strategjisë së aeroportit për të takuar organizatat e mëdha ndërkombëtare dhe partnerët e turizmit me qëllim për të promovuar vendin në formë efektive në tregun ndërkombëtar të turizmit.

Në ITB u mbajt një konferencë për shtyp nga TIA dhe partnerët e saj me përfaqësues të medias ndërkombëtare, përfshirë gazetarë nga tregu Gjerman i turizmit. Aeroporti tregoi mbështetjen për eventin nëpërmjet organizimit të tij dhe prezantimit të Shqipërisë si një destinacion interesant turistik.

Konferenca për shtyp u dha nga Ministria Shqiptare për Zhvillimin Urban dhe Turizmin, Znj. Eglantina Gjermeni, Ambasadori në Berlin, Z. Artur Kuko, Drejtoresha e Komunikimit të Tirana International Airport, Znj. Arlinda Çauholli, dhe Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Znj. Julinda Dhame.

Maj 2014

Adria Airways fillon fluturimet nga Tirana në Frankfurt

Tirana International Airport (TIA) organizoi një ceremoni të premtën, më 9 maj 2014, për të shënuar fillimin e fluturimeve të destinacionit të ri nga Tirana në Frankfurt, operuar nga kompania ajrore Adria Airways katër herë në javë përkatësisht të mërkurave, të enjteve, të premteve dhe të shtunave.

Zyrtarë nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Shqipërisë, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Adria Airways dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të Sllovenisë morën pjesë në ceremoninë për fillimin e operimit të destinacionit të ri.

May 2014

Adria Airways begins new route between Tirana and Frankfurt

Tirana International Airport (TIA) held a ceremony on Friday, 9 May 2014 to celebrate the beginning of a new direct route between Tirana and Frankfurt. The four-times-a-week service is provided by Adria Airways and will operate on Wednesdays, Thursdays, Fridays and Saturdays.

Officials from Albania's civil aviation authority, Ministry of Transport and Infrastructure, Adria Airways and Slovenia's civil aviation authority participated in the ceremony marking the new route.

June 2014

Charter flight commenced between Slovakia and Albania

Tirana International Airport (TIA) held a ceremony on Monday, 30 June 2014, to celebrate the beginning of a new tourist charter flight between Tirana and Bratislava. The weekly service is provided by Shkodra Travel & Tours agency and will operate on Mondays.

Some 200 tourists arrived from Bratislava on the first flight from Slovakia curious to see Albania and enjoy its sandy beaches.

July 2014

Blue Panorama began flights between Tirana and Ancona

As of 21 July, 2014, Tirana and Ancona was connected by direct flight. The service was scheduled twice weekly

– on Mondays and Fridays – and operational from and to Tirana International Airport (TIA) by the carrier Blue Panorama who are using a Boeing 737 for the route.

July 2014

TIA published the Eighth Environment and Social Bulletin

In July 2014, TIA showed again its commitment to the environment. The eighth Environment and Social Bulletin raised awareness of the concept of quality of life focusing also on global warming. TIA was engaged in many actions that demonstrate this commitment to its employees and the people that travel each day through the Airport.

When it comes to global warming we should all play our individual role. There is a very good reason: environmentally, food waste leads to a wasteful use of chemicals such as fertilisers and pesticides, and of fuel costs for transportation, as well as rotten food, which together increase the amount of methane, one of the most harmful greenhouse gases that contribute to climate change.

September 2014

TIA launched a new design for the official website

On September, Tirana International Airport launched a new design of the official website aiming at facilitating the navigation for its visitors. Daily visits to the website counts approximate 2,000 visitors.

September 2014

Air Serbia launched new route Tirana–Belgrade

On 23 September 2014, Tirana International Airport (TIA) inaugurated a new route between Tirana and Belgrade. Air Serbia, the national carrier, is operating the route three times per week – on Tuesdays, Thursdays and Sundays – with an ATR72.

September 2014

Charter flight between Prague and Albania inaugurated

TIA held a ceremony on Friday, 12 September 2014 to celebrate the beginning of a new tourist charter flight between the capital cities of the Czech Republic and Albania. The weekly service is provided by Enter Air and operates on Fridays.

Some 200 tourists arrived on the first flight from Prague, eager to enjoy Albania's beaches and its wonderful landscapes.

October 2014

Alitalia confirmed 96 weekly flights for winter 2014-2015

On 16 October 2014, Alitalia announced that the winter season would bring 96 weekly flights to different eight Italian destinations. At the ceremony held in Tirana the air carrier expressed its gratitude to Albanian passengers for using the company.

Direct flights assisting passengers during the winter schedule were Rome, Milan, Pisa, Bologna, Bari, Turin, Venice and Genoa, with the flight operated by Airbus A319, A320 and A321.

December 2014

Fit for Future II workshop organised to boost internal communication between directors and managers

On December 2014, the Communication Department organised a Programme of Communication 'Fit For Future II' in Berlin to boost internal communication between TIA's directors and managers. The programme once again was considered valuable and had very good feedback.





Qershor 2014

Fluturime me Charter midis Sllovakisë dhe Shqipërisë

Tirana International Airport (TIA) organizoi një ceremoni të hënën, më 30 qershor 2014, për të festuar fillimin e fluturimit të parë turistik mes Tiranës dhe Bratislavës. Shërbimi i cili ofrohet një herë në javë, është organizuar nga agjencia turistike Shkodra Travel&Tours dhe do të operohet gjatë të hënave.

Më shumë se 200 turistë mbërritën nga Bratislava në fluturimin e parë nga Sllovakia, kureshtarë të shihnin Shqipërinë dhe të pushonin në bregdetin ranor.

Korrik 2014

Blue Panorama filloi fluturimet nga Tirana në Ankona

Duke filluar nga 21 korriku 2014, Tirana dhe Ankona lidhen me një fluturim direkt. Shërbimi i cili ofrohet dy herë në javë – gjatë të hënave dhe të premteve – operohet nga dhe për në Tirana International Airport (TIA) nga Blue Panorama. Kompania ka vënë në përdorim një Boeing 737 për pasagjerët e saj.

Korrik 2014

TIA publikoi Buletinin e tetë Mjedisor dhe Social

Në korrik 2014, TIA tregoi edhe një herë përkushtimin e saj ndaj mjedisit. Buletini i tetë Mjedisor dhe Social synon ndërgjegjësimin mbi konceptin e cilësisë së jetës duke u fokusuar ndër të tjera në ngrohjen globale. TIA u përgjigjet me përpikmëri përgjegjësi sociale dhe të mjedisit duke u përfshirë në disa nisma sociale lehtësisht të dukshme për punonjësit e saj, si dhe për njerëzit që fluturojnë çdo ditë në aeroport.

Kur bëhet fjalë për çështjen e ngrohjes globale, të gjithë duhet të luajmë një rol individual. Ka një arsye shumë të mirë: Ushqimet e papërdorura depozitohen si mbetje në mjedis, që do të thotë keqpërdorim i kimikateve të tilla si plehra dhe pesticide, dhe për transportimin e tyre shpenzohet më shumë lëndë djegëse. Për më tepër, ushqimet e kalbura krijojnë më shumë metan – një prej gazeve më të dëmshme që kontribuon në ndryshimin e klimës.

Shtator 2014

TIA prezanton projektin e ri për faqen e saj zyrtare

Në shtator, Tirana International Airport prezantoi një projekt të ri të faqes zyrtare me qëllim lehtësimin e navigimit nga vizitorët e saj. Klikimet ditore në faqen zyrtare shënojnë përafërsisht 2.000 vizitorë.

Shtator 2014

Air Serbia fillon fluturimet Tiranë–Beograd

Më 23 Shtator 2014, Tirana International Airport (TIA) përuroi fluturimin e parë nga Beogradi në Tiranë. Kompania kombëtare e fluturimit Air Serbia operon tre herë në javë – të martave, të enjteve dhe të dielave – me një avion të tipit ATR72.

Shtator 2014

Filluan fluturimet turistike mes Pragës dhe Tiranës

Tirana International Airport (TIA) organizoi një ceremoni të premten më 12 shtator 2014, për të përvuatur fillimin e fluturimit të parë turistik mes kryeqyteteve të Republikës Çeke dhe Tiranës. Shërbimi i cili ofrohet një herë në javë, është organizuar nga kompania ajrore Enter Air dhe do të operohet gjatë të premteve.

Më shumë se 200 turistë çekë mbërritën nga Praga në fluturimin e parë, kureshtarë të shihnin natyrën e Shqipërisë dhe plazhet e saj.

Tetor 2014

Alitalia konfirmon 96 fluturime në javë për sezonin e dimrit 2014-15

Më 16 tetor 2014, Alitalia lajmëroi se sezoni i dimrit 2014-15 parashikonte 96 fluturime në javë drejt tetë destinacioneve të ndryshme në Itali. Në një ceremoni të zhvilluar ditën e enjte në Tiranë, kompania ajrore shprehu mirënjohjen për pasagjerët shqiptarë.

Fluturimet direkte që do të pasonin me sezonin e dimrit përfshijnë Romën, Milanon, Pizën, Bolonjën, Torinon, Veneçian dhe Xhenovën dhe operohen me avionë të tipit Airbus A319, A320 dhe A321.

Dhjetor 2014

TIA organizon seminarin Fit for Future II me qëllim nxitjen e komunikimit të brendshëm ndërmjet drejtorëve dhe menaxherëve

Në dhjetor 2014, Departamenti i Komunikimit organizoi Programin e Komunikimit Fit for Future II në Berlin për të nxitur komunikimin e brendshëm ndërmjet menaxherëve dhe drejtorëve të TIA-s. Theksojmë se programi u konsiderua me vlerë dhe pati rezultate pozitive.



Key Figures

Shifrat Kryesore



In 2014, TIA served 1,810,305 passengers (Table 3). The Airport also recorded 17,928 air traffic movements (ATMs) and handled 2,324 tons of cargo.

In comparison with the previous year, passenger numbers increased by 3 per cent, ATMs decreased by 10.1 per cent and cargo increased by 7.4 per cent.

Last year, twenty airlines operated in to and out of TIA, connecting directly the Albanian capital city with 26 destinations.

TIA is committed to offering its passengers, airlines and business customers the best service..

Key figures and growth in percentages

Key Figures	2013	2014
Passengers	1,757,342 (+5.5%)	1,810,305 (+3.0%)
ATMs	19,942 (-2.9%)	17,928 (-10.1%)
Cargo (Tons)	2,164 (-4.2%)	2,324 (+7.4%)

Në vitin 2014 TIA u shërbeu në total 1,810,305 pasagjerëve. Aeroporti gjithashtu rregjistroi 17,928 lëvizje trafiku ajror (ATMs) dhe përpunimin e 2,324 ton ngarkesave.

Në krahasim me vitin e kaluar, numri i pasagjerëve është rritur me 3%, ATM-të (lëvizjet në trafikun ajror) kanë pësuar një rënie me 10,1% dhe sasia e ngarkesës së përpunuar ka pësuar një rritje me 7,4%.

Gjatë vitit të kaluar kanë operuar njëzet linja ajrore në dhe nga Aeroporti, të cilat kanë lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë kryeqytetin shqiptar me 26 destinacione.

TIA është e angazhuar t'i ofrojë pasagjerëve të vet, linjave ajrore dhe klientëve të biznesit shërbimin më të mirë të mundshëm.

Shifrat kryesore dhe përqindja e rritjes

Shifrat kryesore	2013	2014
Pasagjerë	1,757,342 (+5.5%)	1,810,305 (+3.0%)
ATM	19,942 (-2.9%)	17,928 (-10.1%)
Ngarkesa (Kargo) në tonë	2,164 (-4.2%)	2,324 (+7.4%)



Tirana International Airport SHPK

**Tirana International Airport Nënë Tereza
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania
Phone: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
info@tirana-airport.com
www.tirana-airport.com**

**Corporate Affairs and Environment Department
Departamenti i Menaxhimit të Grupeve të Interesit dhe Mjedisit**

Status: July 2015
Botimi: Korrik 2015